



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 03.05.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **29.04.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Agani LTD, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me Barna nga Lista Esenciale" Lot 39** me Nr. të Prok: **206-24-582-1-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

1. **PRANOHET**, si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **Agani LTD** e dt. 29.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me Barna nga Lista Esenciale" Lot 39** me Nr. të Prok: **206-24-582-1-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK të datës 26.04.2024.
2. **Anullohet**, Njoftimi mbi vendimin e AK, i datës 26.04.2024 për Lot 39;
3. Autoriteti Kontraktues, kthen në Ri-vlerësim aktivitetin e prokurimit për Lot 39;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Agani LTD me datën 29.04.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizim me Barna nga Lista Esenciale" Lot 39** me Nr. të Prok: **206-24-582-1-1-1**. AK-MSh, me datë 03.05.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Njoftimi mbi Vendimin e AK është në kundërshtim me dispozitat e LPP konform Neneve 1, 7, 59, 60 dhe 64

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Çmimi i ofertuar nga kompania jone prej 35.39 EUR është në përputhje të plote me Sqarimet Shtese për OE të publikuar nga AK me datë 07.03.2024 ku është shënuar qartë nga AK se çmimi për këto produkt duhet të jetë 35.39 EUR

Dëmet materiale

Kerkojme nga AK te rishqyrtoje Vendimin per Lot-39 ne ate menyre qe te shpalle kompanine tone fituese pasi qe kemi ofertuar me produkt i cili eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat e AK per kete aktivitet prokurimi

Përgjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Pretendimin e juaj ankimor e konsiderojme te bazuar, duke marre parasysh se ne fazen e tenderimit me daten 07.03.2024 eshte trajtuar çmimi i parashikuar per Lot 39 – produkti Anti-D Immunoglobulin, dhe sipas rekomandimit te Njesise se Kerkeses – Div. Farmaceutik, eshte sqaruar se: *Ndërsa sa i përket çmimit, çmimi për këtë produkt është inicuar me kontratën e fundit me çmimin 31.27 €, por pas verifikimit nga komisioni për hulumtim të çmimit konsiderojmë se çmimi i përlogaritur duhet te jetë për njësi 35.39 euro.*

Oferta juaj ne këtë aktivitet ka qene sakt 35.39 euro sa është lejuar me sqarime shtese, andaj ky çmim është i pranueshëm për AK-MSh, por qe gjate vlerësimit te tenderit është harruar te trajtohet nga komisioni vlerësues.

Duke marre parasysh se produkti është mjaft i rëndësishëm për furnizim, si ZPP vendosi për aprovimin e kërkesës tuaj dhe qe lënda te kthehet ne Ri-vlerësim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit